



27 shkurt, 2012

Nga: **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Për: **Z. Arben Gjukaj, Drejtor Menaxhues, KEK Sh.a**

**Z. Fadil Ismajli, Drejtor Menaxhues, KOSTT Sh.a**

Kopje: **Z. Besim Beqaj, Ministër për Zhvillim Ekonomik**

**Z. Zenun Pajaziti, Kryetar i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri**

**Z. Petrit Pepaj, Drejtor për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KEK Sh.A**

**Znj. Resmije Ahma, Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.A**

**Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës**

**Lënda: Shqyrtimi i gjashtë të tarifave të energjisë elektrike (SHTe6) – Raportet Konsultative**

Të nderuar-a zonja dhe zotërinj,

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e Shqyrtimit të Gjashtë të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTe6). Procesi i shqyrtimit të tarifave përfshin përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR) që të licencuarit në shqyrtim i lejohet të mbledhë për shërbimet e rregulluara që ofron. MAR-i i përcaktuar me këtë shqyrtim pritet të hyjë në fuqi që nga 1 prilli 2012.

Bashkëngjitur po ua dërgojmë Raportet Konsultative të Zyrës së Rregullatorit për Energji, lidhur me aplikacionet e Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës sh.a. (KOSTT). Këto Raporte po ua dërgojmë me qëllim të pranimit të komenteve tuaja eventuale dhe të palëve të interesit për vlerësimet e ZRRE-së. Raporti përmban edhe propozimet preliminare për të Hyrat e Lejuara për KEK-un dhe KOSTT-in, të cilat do të shërbejnë si bazë për përcaktimin e tarifave. Vendimi përfundimtar mbi tarifatat do të merret pas rishikimit të komenteve dhe mund të ndryshojë nga propozimet që jepen në këtë raport.

Komentet tuaja mund t'i dërgoni në ZRRE deri më **12 mars 2012**. Komentet mund të dërgohen përmes postës elektronike në adresën [ero.pricing-tariffs@ero-ks.org](mailto:ero.pricing-tariffs@ero-ks.org), me titull "Komentet për SHTe6", apo të shtypura, në adresën "Rruga Hamdi Mramori Nr. 1 10000 Prishtinë", ku në rubrikën e lëndës të shkruhet "Për Departamentin për Tarifa dhe Çmime".

Me respekt,

Përparim Kabashi

Blerim Koci

Enver Halimi